

V ENDIM
Nr.771, datë 10.11.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI
DHE RIKONSTRUKSIONI I PIKËS KUFITARE MORINË-KUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi dhe rikonstruksioni i pikës kufitare Morinë - Kukës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen, tokë arë, prej 8410 (tetë mijë e katërqind e dhjetë) m², me vlerë 1 404 470 (një milion e katërqind e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë, për truallin, me sipërfaqe 1250 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë) m², me vlerë 1 338 855 (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për objekt, me vlerë 5 322 689.36 (pesë milionë e treqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 8 060 014.36 (tetë milionë e gjashtëdhjetë mijë e katërmbydhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 8 060 014.36 (tetë milionë e gjashtëdhjetë mijë e katërmbydhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondet e programuara në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

6. Pronarët e pasurisë, për të cilën është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, si dhe atij tekniko-ligjor.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “I pakonfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” dhe “I pakonfirmuar nga ZVRPP-ja”, në bazë të pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të fillojnë procedurat për të bërë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha